



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR

RREGULLORE

Nr. 2, datë 01.02.2007

Rregullore e funksionimit te Struktures Ekzekutive IKM

Rregullorja e funksionimit te Drejtorit ekzekutiv dhe Struktures ekzekutive hartohet ne perputhje me nenin 21 te statutit dhe eshte e miratuar nga Keshilli i Drejtimit te IKM.

Organika e Struktures ekzekutive

Organika e struktures ekzekutive te IKM perbehet nga 3 (tre) vete dhe paraqitet si meposhte:

1. Drejtori Ekzekutiv
2. Mbajtesi i llogarive
3. Sekretar-arketar

Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv eshte drejtues i struktures ekzekutive. Ai kryen administrimin ekonomik, financiar dhe veprimtarin e pergjithshme ekzekutive te IKM nepermejt kesaj strukture ekzekutive.

Drejtori Ekzekutiv, si drejtues i Struktures ekzekutive ka keto detyra:

- Te organizoje dhe drejtoje te gjithe aktivitein e struktures ekzekutive
- Te drejtoje punen per organizimin e mbledhjeve te KD dhe te KZKDS te IKM, te mbledhjes se asamblese se pergjithsme te IKM, dhe te aktiviteteve te tjera.
- Brenda muajit Shkurt paraqet per miratim ne Keshillin e Drejtimit projekt buxhetin e vitit.
- Te autorizojte kryejren e pagesave nga arka dhe banka.
- Te kryejte blerje dhe pagesa per sherbimet e nevojshme per funksionimin e struktures ekzekutive, te zyrave te IKM, dhe aktivitetete te tjera te nevojshme te IKM per shuma deri ne 200,000 leke, per shuma mbi 200,000 deri ne 500,000 leke mere miratimin paraprake te presidentit te IKM dhe per shuma mbi kete kufi merr autorizimin e Keshillit te Drejtimit.
- Bazuar ne buxhetin e miratuar nga asambleja, bene ndarjen e buxhetit ne mujor

